



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Drejtuar: Operatorit Ekonomik: “**ERALD-G**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K36306784K**, me seli:
Dibër, Peshkopi, Herbel, Ndërtesa private Nr.61.

Procedura e prokurimit: “**E Hapur e Thjeshtuar - Shërbime**”, prokurim elektronik

Numri i referencës së procedurës: **REF-78150-08-23-2023**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Loti Nr. 3: “Mbikqyrje të punimeve për investimin me objekt: “Ndërtim shkolla “Rexhep Kërtuka” Frankth, Bashkia Mat (Faza II)”**, me fond limit në vlerën: **90 480.94** (nëntëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë pikë nëntëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH**, me afat realizimi: **60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit** (i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet).

Publikime të mëparshme: *nuk ka patur*

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 73, datë 28 Gusht 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1. Operatori Ekonomik: “G B Civil Engineering” Sh.p.k.,** me numër Nipt-i: **L51825011V**.
Vlera: **70 720.12** (shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet pikë dymbëdhjetë) **lekë pa TVSH.**
- 2. Operatori Ekonomik: “PROJECT DALUZ 2019” Sh.p.k.,** me numër Nipt-i: **L92112031B**.
Vlera: **70 422.1** (shtatëdhjetë mijë e katërqind e njëzet e dy pikë një) **lekë pa TVSH.**

3. Operatori Ekonomik: “ERALD-G” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K36306784K.**

Vlera: **90 450** (nëntëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë) **lekë pa TVSH.**

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- 1. Operatori Ekonomik: “G B Civil Engineering” Sh.p.k.,** me numër Nipt-i: **L51825011V.**
- 2. Operatori Ekonomik: “PROJECT DALUZ 2019” Sh.p.k.,** me numër Nipt-i: **L92112031B.**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

I. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “G B Civil Engineering” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:

1. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.5/ 2.3** Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se:
 - nuk është paraqitur Analiza e përlogaritjes së ofertës sipas përcaktimeve të VKM-së Nr.354, datë 11.05.2016, e cila është kusht për s’kualifikim, si dhe
 - çmimi i ofertuar është nën vlerën e minimale të lejuar përlogaritur në zbatim të VKM-së Nr.354, datë 11.5.2016 “*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim të territorit*” për këtë objekt prokurimi, ku si rrjedhojë bazuar në përcaktimet e nenit 7/1 të kësaj VKM-je oferta Juaj refuzohet.

II. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “PROJECT DALUZ 2019” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:

1. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 1 gërma “b”**/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës nuk është paraqitur sigurimi i ofertës, *sipas shtojcës 3.*
2. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.1/ 2.3** Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, shërbimi për mbikqyerjen e punimeve të objektit “Godinë banimi dhe shërbimi 3, 6 dhe 9 kat me 3 kat parkim nëntokë” (kontrata noteriale e punës me Nr.Rep.895, Nr.Kol.635, datë 03.03.2021) nuk ka përfunduar ende, ndërsa shërbimi i mëparshëm i kryer për kontratën e datës 03.02.2020 me objekt “Mbikqyerjen e punimeve për objektin godinë polifunksionale 3 kate me podrum deri në kuotën +-0.00” referuar datës së faturës tatimore shitje të lëshuar nga mbikqyrësi datë 17.06.2020, është jashtë afatit 3 (tre) vjeçar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

3. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.5/ 2.3** Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se:
- nuk është paraqitur Analiza e përlllogaritjes së ofertës sipas përcaktimeve të VKM-së Nr.354, datë 11.05.2016, e cila është kusht për s'kualifikim, si dhe
 - çmimi i ofertuar është nën vlerën e minimale të lejuar përlllogaritur në zbatim të VKM-së Nr.354, datë 11.5.2016 “*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim të territorit*” për këtë objekt prokurimi, ku si rrjedhojë bazuar në përcaktimet e nenit 7/1 të kësaj VKM-je oferta Juaj refuzohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: “**ERALD-G**” Sh.p.k., me seli: *Dibër, Peshkopi, Herbel, Ndërtesa private Nr.61*, me numër Nipt-i: **K36306784K**, se oferta e paraqitur, me vlerë të përgjithshme prej: **90 450** (*nëntëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë*) **lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkisë Mat/ Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike, me adresë: *Sheshi “Kastriotët”, Nr.1, KP 8001, Burrel*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **10** (*dhjetë*) **ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

Titullari i Autoritetit Kontraktor